



SBASHK Arsimimi sot

Janar, 2023

Gazeta elektronike

Fillim i mbarë i agjendës së takimeve nëpër komunat e Kosovës Sindikata e Arsimit Parauniversitar në Prizren mbajti Kuvend pune



Në takimin konsultativ me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve u debatuan shumë çështje aktuale në arsim dhe u morën vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me aktivitetin sindikal për ditët në vijim. Duke e vlerësuar të rëndësishëm komunikimin me kryetarët e shoqatave sindikale u mor vendim që të fillohet me agjendën e vizitave nëpër komuna dhe Universitete. Kjo agjendë ka filluar të realizohet në Prizren përmes një takimi të suksesshëm pune të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë...(faqe 4)

Kuvend pune në Skenderaj
Respekt i lartë për
angazhimet e stafit qendror të
SBASHK-ut

Në kujtesën e kryetarit të
SBASHK-ut ...(faqe 7)

Flet kryetari i Kuvendit
të Sindikatës së Arsimit
Parauniversitar të Kaçanikut
**Berisha - Unik e të bashkuar
do të arrijmë të kryejmë
detyrat që na presin**



Islam Berisha është
mësimdhënës i gjuhës
angleze...(faqe 3)

Aktiviteti domethënës i SBASHK-ut në Drenas Trajnimi për aplikimin e programeve kompjuterike në mësimdhënie



SBASHK-u me qëllim që t'u dalë në ...(faqe 5)

Kuvende të suksesshme pune në Kamenicë dhe në Viti Respekt për punën dhe angazhimin e SBASHK-ut



Duke vazhduar me realizimin ...(faqe 5-6)



Editorial

Na qoftë i mbarë ky vit



Janari i vitit 2023 ka shënuar vazhdimin e aktiviteteve të SBASHK-ut në realizimin e planifikimit të aktiviteteve. Në eKosova vazhdon të shtohet numri i anëtarëve dhe kjo është dëshmi se anëtarësia vlerëson dhe respekton angazhimet e stafit qendror dhe të veprimtarëve sindikal si zë i tyre i fuqishëm. SBASHK-u për të bashkëbiseduar me veprimtarët sindikal nëpër komuna e Universitete ka bërë një agjendë të takimeve, e cila ka filluar të realizohet. Në këto Kuvende pune po zhvillohet bashkëbisedë me pjesëmarrësit për të gjitha çështjet aktuale sindikale. Këto takime dëshmojnë unitetin dhe respektin e anëtarësisë për sindikatën e tyre. Ata bëjnë

pyetje për çështje konkrete, por edhe japin ide konkrete për ndonjërin prej aktiviteteve.

SBASHK-u edhe në muajin e parë të vitit 2023 ka bërë gjithë përgatitjet dhe ka rinisur edhe me aktivitetin e trajnimeve, që kanë për qëllim të ndihmojnë punëtorët arsimor në përpjekjet e tyre të vazhdueshme për ngritjen e cilësisë në arsim. Të punësuarit në gjithë sektorin e arsimit, që nga çerdhet e deri në Universitete, por edhe në sektorët tjerë janë në pritje të publikimit të vlerës së koeficientit dhe duan të besojnë se Ligji i pagave, për të cilin SBASHK-u ka bërë gjithë ato angazhime, do të jetë ai që sjell ngritje pagash dhe do të jetë i pranueshëm për të punësuarit në sistemin arsimor.

Të urojmë bashkë me suksese e angazhime të reja. Na qoftë i mbarë ky vit.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Flet kryetari i Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Kaçanikut

Berisha - Unik e të bashkuar do të arrijmë të kryejmë detyrat që na presin



Islam Berisha është mesimdhënës i gjuhës angleze. Krahas angazhimeve në procesin mesimor, Islami tregoi përkushtim edhe në angazhimet sindikale si kryetar i shoqatës në shkollën e tij. Pasi kolegu ynë

Fevzi Bunjaku, që ishte shembull i shkëlqyer prej sindikalisti, shkoi u pensionua, në Kaçanik u mbajt Kuvend zgjedhor dhe pjesëmarrësit me votën e tyre të fshehtë besimin ia dhanë kolegut Islam Berisha. Me të zhvilluam këtë intervistë për gazetën tonë.

Arsimimi sot:

Kush është Islam Berisha?

Islami:

Vij nga Dubrava, Komuna e Kaçanikut. Jam mesimdhënës i gjuhës angleze në SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë. Kam përfunduar SHLP në Prizren- drejtimi Gjuhë dhe Letërsi angleze e më vonë kam mbaruar edhe programin AKM në UP, dega në Gjilan, po i njëjti drejtim.

Punën e mesimdhënësit e kam filluar qysh para luftës, që nga prilli i vitit 1993 si arsimtar i gjuhës angleze deri në fund të vitit 1999, pastaj kam pasur një ndërprerje të angazhimit në arsim për t’u rikthyer përsëri në shtator të vitit 2007. Kam qenë anëtar i sindikatës që nga viti 1993, për t’iu bashkangjitur përsëri në vitin 2007, fillimisht si anëtar e pastaj u zgjedha edhe kryetar i shoqatës së SHFMU “Kadri Zeka” në Dubravë për tri mandate rresht e që nga dhjetori i vitit 2022 jam zgjedhur Kryetar i Sindikatës Komunale dega në Kaçanik.

Arsimimi sot:

Si ndjeheni pas besimit që morët nga koleget/ kolegët në Kaçanik?

Islami:

Ka qenë insistimi i kolegeve e kolegëve që unë të kandidoj për kryetar të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën tonë e që tregon besimin e tyre, për të cilën unë jam shumë falënderues ndaj të gjithëve, por me besimin vjen edhe përgjegjësia ndaj gjithë anëtarësisë e që besoj të bashkuar do të arrijmë të jemi në nivel të përgjegjësisë së kryerjes të detyrave që janë para nesh.

Arsimimi sot:

Cilat momente i veçoni nga aktiviteti juaj sindikal?

Islami:

Mes shumë aktiviteteve, e veçantë ka qenë pjesëmarrja ime në punëtorinë e parë të organizuar për hartimin e strategjisë së SBASHK-ut, pjesëmarrja në kuvende zgjedhore nëpër shkolla, po ashtu kam qenë edhe kryetar i Këshillit Grevist për Komunën e Kaçanikut në grevën e fundit dhe vizitat në shkolla dhe uniteti i treguar vërtet ishte diçka mbresëlënëse për mua dhe jam falënderues ndaj gjithë anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Në çka duhet orientuar më shumë aktivitetin e SBASHK-ut?

Islami:

Mendoj që SBASHK-u duhet të vazhdojë aktivitetin kryesor e që është mirëqenia e të gjithë anëtarëve të sindikatës, po ashtu të orientoj aktivitetin duke kërkuar kushte më të mira të punës, të vazhdojë me trajnimet e mesimdhënësve dhe me aktivitete të tjera në shërbim të anëtarësisë.

Arsimimi sot:

Cili është mesazhi juaj për koleget e kolegët kudo në Kosovë?

Islami:

Uroj që të gjithë koleget e kolegët të gëzojnë shëndet, të qëndrojmë të bashkuar përpara sfidave dhe në përkrahje të udhëheqjes së SBASHK –ut, organizatës sindikale më të organizuar në nivel shteti e më gjerë. Vazhdoni punën tuaj prej mesimdhënësi me plot përkushtim e krenari.

Gjatë muajit

Fillim i mbarë i agjendës së takimeve nëpër komunat e Kosovës **Sindikata e Arsimit Parauniversitar në Prizren mbajti Kuvend pune**

Në takimin konsultativ me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të universiteteve u debatuan shumë çështje aktuale në arsim dhe u morën vendime të rëndësishme që kanë të bëjnë me aktivitetin sindikal për ditët në vijim. Duke e vlerësuar të rëndësishëm komunikimin me kryetarët e shoqatave sindikale u mor vendim që të fillohet me agjendën e vizitave nëpër komuna dhe Universitete.



Kjo agjendë ka filluar të realizohet në Prizren përmes një takimi të suksesshëm pune të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë. Pjesëmarrja e një numri të madh të kryetareve e kryetarëve të shoqatave sindikale nga institucionet e arsimit të Prizrenit ka dëshmuar edhe një herë unitetin dhe organizimin e mirë sindikal në këtë komunë.



Para se të niste punimet ky Kuvend kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i shoqëruar nga nënkryetarja Vjollca Shala, koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetari i këtij Kuvendi Reshit Kushaj kanë vizituar Drejtorinë Arsimore dhe janë takuar me drejtoreshën Luljeta Veselaj-Gutaj.



Kryetari Jasharaj në bashkëbisedë me drejtoreshën Veselaj-Gutaj ka folur për aktivitetet e zhvilluara të SBASHK-ut në nivelin qendror dhe në komunën e Prizrenit dhe ka shprehur respekt për angazhimet e kryetarit Kushaj, të kryesisë, por edhe të shumë veprimtarëve sindikal në këtë komunë. Ai është shprehur i bindur se edhe në të ardhmen Prizreni do të jetë shembull i mirë i bashkëpunimit dhe i angazhimeve e arritjeve sindikale. Drejtoresha Luljeta Veselaj-Gutaj ka shprehur respekt për angazhimet dhe arritjet e SBASHK-ut dhe ka lavdëruar angazhimet e bashkëpunimit me sindikatën në Prizren në përpjekje për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë dhe për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim.



Në hapje të punimeve të Kuvendit të punës, kryetari Reshit Kushaj ka përshëndetur të pranishmit duke i falënderuar që i janë përgjigjur në numër kaq të madh ftesës për takim e pastaj ka falënderuar kryetarin Jasharaj, nënkryetaren Shala dhe koordinatorin Ymeri për pjesëmarrje në këtë takim duke u shprehur i bindur se ata do të ndihmojnë për rrjedhën e mbarë të këtij takimi. Ai ka shprehur respekt të lartë për angazhimet e kryetarit Jasharaj dhe stafit qendror.

Kryetari Jasharaj në fjalën përshëndetëse ka shprehur respekt meritore për koleget dhe kolegët sindikalistë që janë shembull i shkëlqyer i unitetit dhe përkushtimit. “Në kohë të sfidave Reshiti ishte angazhuar të na ndihmonte

në qendër dhe ka qenë në nivel të lartë të angazhimit. Jasharaj ka falënderuar për angazhimin kolegen Hyrije Hoti, kryesinë dhe veprimtarët tjerë sindikal që kanë treguar përkushtim dhe angazhim të lartë sindikal në Prizren.

Në vazhdim të këtij Kuvendi pjesëmarrësit kanë shtruar shumë pyetje nga aktualiteti sindikal dhe në arsim dhe kanë marrë përgjigje të qarta nga nënkryetarja Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri.



Aktivitet domethënës i SBASHK-ut në Drenas

Trajnimi për aplikimin e programeve kompjuterike në mësimdhënie

SBASHK-u me qëllim që t'u dalë në ndihmë anëtarësisë në përpjekjet e tyre për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim ka organizuar një aktivitet tepër domethënës për realizimin e tetë trajnimeve të licencuara. Ky aktivitet po vazhdon edhe në vitin 2023. Kështu duke respektuar vullnetin e anëtarësisë nga disa shkolla të Drenasit e në koordinim me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë Ilaz Dervishi, ka filluar të shtunën e 28 janarit me trajnimin për aplikimin e programeve kompjuterike në mësimdhënie, udhëhequr nga trajneri Fejzullah Berisha.



Ky aktivitet u realizua edhe të dielën e 29 janarit në ambientet e Gjimnazit "Skënderbeu" për të vazhduar edhe në ditët tjera sipas marrëveshjes së trajnerit dhe pjesëmarrësve.



Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti i ka vizituar koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke i përgëzuar për vullnetin e tyre që edhe në ditë vikendi janë të përkushtuar për arritje të njohurive të reja në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë në arsim.



Kryetari Dervishi ka shprehur respekt për stafin qendror të SBASHK-ut që vazhdon angazhimet për të realizuar kërkesat e anëtarësisë e për të ndihmuar ata edhe përmes trajnimeve që më lehtë të realizojnë misionin e shenjtë për arsimimin e edukimin e brezave.

Kuvende të suksesshme pune në Kamenicë dhe në Viti

Respekt për punën dhe angazhimin e SBASHK-ut



Duke vazhduar me realizimin e agjendës së takimeve me veprimtarë sindikalë, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë shkuar në Kamenicë për të marrë pjesë në Kuvendin e Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të kësaj komune. Ky Kuvend u mbajt në ambientet e gjimnazit "Ismail Qemali".

Në hapje të këtij kuvendi kryetari Lulzim Thaqi ka përshëndetur të pranishmit duke falënderuar edhe në emër të tyre kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

dhe koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Ai pastaj ka shpalosur disa nga aktivitetet e zhvilluara në këtë komunë duke veçuar edhe rrjedhën e mbarë të regjistrimit të punëtorëve arsimor nga kjo komunë në platformën eKosova.



Kryetari i SBASHK-ut Jasharaj ka deklaruar se në Kamenicë ka ardhur për të përgëzuar kryetarin Thaqi por edhe gjithë kolegët për angazhimin dhe unitetin e treguar në SBASHK. Pas kësaj shumë nga pjesëmarrësit e këtij takimi kanë bërë pyetje konkrete që lidhen me aktivitetin sindikal. Në këto pyetje është përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke dhënë sqarimet e duhura. Ky takim dëshmon për unitetin e anëtarësisë së kësaj komune në SBASHK dhe bashkërisht janë dhënë ide për aktivitete sindikale në të ardhmen.

Po këtë ditë është mbajtur Kuvend pune edhe i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Vitisë. Fillimisht kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatorin për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe kryetarin e sindikatës sonë për këtë komunë Kemajl Bislmi kanë vizituar Drejtorinë e Arsimit dhe kanë bashkëbiseduar me drejtoreshën Fatbardha Emini.



Kryetari Jasharaj ka falënderuar drejtoreshën Emini për bashkëpunimin korrekt e në shërbim të arsimit me përfaqësuesit sindikal në këtë komunë dhe ka lavdëruar angazhimin dhe përkushtimin e kryetarit Kemajl Bislmi, të kryesisë dhe të veprimtarëve sindikalë në këtë komunë në shërbim të realizimit të kërkesave legjitime të

anëtarësisë. Drejtoresha e DKA-së në Viti ka falënderuar mysafirët për vizitën dhe ka shprehur respekt për gjithë angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë dhe arsimit në përgjithësi duke veçuar edhe organizimin e shumë trajnimeve për punëtorët arsimor me qëllim që ata të ndihmohen në ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim. Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë pritur në një takim edhe nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Bekim Hazizi me të cilin kanë bashkëbiseduar për aktualitetin në arsimin e kësaj komune dhe për sfidat aktuale.



Pas kësaj ka nisur punimet Kuvendi i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për komunën e Vitisë. Në hapje të takimit kryetari Kemajl Bislmi ka përshëndetur të pranishmit e pastaj ka falënderuar kryetarin Jasharaj dhe koordinatorin Ymeri për pjesëmarrje duke u shprehur se ata do të japin kontribut të çmuar edhe në rrjedhën e këtij Kuvendi.



Kryetari i SBASHK-ut në fjalën përshëndetëse ka përgëzuar kryetarin Bislmi, kryesinë dhe veprimtarët sindikal për angazhimet dhe i ka falënderuar për mbështetjen e besimin duke u shprehur se bashkërisht do të vazhdojmë me angazhimet e përkushtimin drejt realizimit të detyrave në shërbim të arsimit dhe anëtarësisë.

Në pjesën e dytë të këtij takimi ka nisur bashkëbiseda me pjesëmarrësit dhe në pyetjet e tyre është përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke sqaruar gjithë çështjet e ngritura në këtë bashkëbisedë. Pjesëmarrësit e këtij Kuvendi kanë shprehur respekt meritore për angazhimet e SBASHK-ut me bindjen e plotë se bashkërisht e me unitet do të vazhdohet rrugëtimi drejt realizimit të detyrave konkrete sindikale.

Në kujtesën e kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj



Kuvend pune në Skenderaj

Respekt i lartë për angazhimet e stafit qendror të SBASHK-ut

dhe zyrtarit ligjor Blendor Shatri për një kohë të gjatë do të mbesin momentet e kaluara dhe pamjet e krijuara nga moti i lig dhe vërshimet që ndodhën në Skenderaj.

Në këtë atmosferë plot shqetësim kryetari Jasharaj bashkë me zyrtarin ligjor Shatri dhe me kryetarin e Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për këtë komunë janë takuar me kryetarin e Skenderajt Fadil Nura dhe drejtorin e DKA-së Kastriot Duraku. Kryetari i SBASHK-ut ka falënderuar kryetarin z.Nura dhe drejtorin z.Duraku për bashkëpunimin me kryetarin Polaci dhe për angazhimet e përbashkëta në realizimin e kërkesave të punëtorëve arsimorë nga kjo komunë.



Kryetari i Skenderajt ka falënderuar për vizitën dhe ka shprehur gatishmërinë që edhe në të ardhmen të vazhdohet me bashkëpunimin me qëllim që të gjitha çështjet të realizohen me përpjekje të përbashkëta dhe nga ky takim ka dalë që të jetë pranë njerëzve që po përjetojnë një situatë të paparë nga vërshimet, situatë kjo që sa shkonte po bëhej edhe më dramatike. Para se të fillonte kuvendi i punës përfaqësuesit e SBASHK-ut janë takuar me drejtorin e Gjimnazit “Hamëz Jashari” me z.Hajdar Beka, i cili pasi ka falënderuar mysafirët për vizitën ka folur për angazhimet që vazhdojnë të

bëhen në këtë institucion arsimorë në shërbim të ngritjes së vazhdueshme të cilësisë.



Pas kësaj në ambientet e këtij gjimnazi ka filluar punimet kuvendi i punës i sindikatës së arsimit parauniversitar të Skenderajt. Kryetari Polaci ka falënderuar pjesëmarrësit të cilët edhe përkundër motit të ligë e faktit që një pjesë e qytezës po përmytej kishin ardhur në këtë takim. Polaci ka shprehur respekt në emër të gjithë të punësuarve në arsim në këtë komunë për mysafirët dhe angazhimet e shumta të SBASHK-ut.



Kryetari Jasharaj ka falënderuar pjesëmarrësit dhe gjithë koleget e kolegët të Skenderajt për unitetin dhe qëndrimin dinjitoz në grevë dhe pas saj. Pjesëmarrësit kanë bërë pyetje, të cilave në mënyrë konkrete e duke ofruar fakte të mjaftueshme u është përgjigjur zyrtari ligjor i SBASHK-ut Blendor Shatri. Pjesëmarrësve të këtij takimi do t'u mbetet në kujtesë edhe momenti teksa po përgatiteshim për tu kthyer nga ky takim, oborri i Gjimnazit po i ngjate një liqeni e një sasi e madhe e ujit filloi të depërtonte edhe në ambientet e brendshme.

Tri institucione shëndetësore dëshmojnë respektin për punëtorët arsimor

Zbritje çmimesh të shërbimeve për anëtarët e SBASHK-ut

Një arritje e veçantë e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë është edhe nënshkrimi i marrëveshjeve me institucione shëndetësore e rekreative për zbritje çmimesh për shërbimet e kryera për anëtarët e SBASHK-ut. Numri i këtyre marrëveshjeve është më shumë se 130 dhe ky angazhim po vazhdon. Kështu falë angazhimit të kryetarit Lulzim Thaçi dhe kryesisë së Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar të Kamenicës dhe respektit që njerëz të vullnetit të mirë kanë për punëtorët arsimorë që janë anëtarë të SBASHK-ut, janë nënshkruar edhe tri marrëveshje me institucione private shëndetësore për zbritje të çmimeve për shërbimet në këto institucione.



Në marrëveshjen e nënshkruar në emër të SBASHK-ut nga Lulzim Thaçi dhe në emër të laboratorit “LITOLAB”, nënshkruar nga z. Faton Hajrullahu thuhet se zbritja e shërbimeve do të jetë 15% për anëtarët e SBASHK-ut, ndërsa për anëtarët e familjes së ngushtë të tyre zbritje 10%.

Në marrëveshjen e nënshkruar nga z. Betim Thaqi, përfaqësues i Ordinancës për Terapi Fizikale dhe Rehabilitim “FIZIO-ACTIVE” thuhet se për anëtarët e SBASHK-ut në këtë institucion shëndetësor do të ketë zbritje prej 15% të shërbimeve.



Në marrëveshjen e mirëkuptimit me Klinikën Dentare “Redentis”, nënshkruar nga dr. Reis Morina thuhet se shërbimet këtu për anëtarët e SBASHK-ut janë në zbritje prej 10%.



Në këto tri marrëveshje precizohet se anëtarët e SBASHK-ut me të paraqitur në këto institucione shëndetësore duhet të identifikohen me lejet e njoftimit dhe bëjnë pagesën sipas rregullave të këtyre institucioneve shëndetësore duke gëzuar zbritjet në shërbime sipas marrëveshjeve të nënshkruara nga përfaqësuesi i SBASHK-ut

Lulzim Thaqi dhe përfaqësuesit e këtyre institucioneve shëndetësore. Punëtorët arsimorë që nuk janë të regjistruar si anëtarë të SBASHK-ut në eKosova nuk i gëzojnë këto zbritje çmimesh nga këto tri marrëveshje.

Kuvend i suksesshëm pune edhe në Ferizaj Angazhim i përbashkët për të shënuar arritje të reja

Në kuadër të realizimit të agjendës së takimeve me veprimtarët sindikalë nëpër komunat e Kosovës, kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë vizituar komunën e Ferizajt. Ata fillimisht janë takuar me kryetarin e sindikatës sonë për Ferizajn Fejzullah Vranovci, kryetaren e kuvendit të sindikatës së arsimit të mesëm të lartë Hanife Salihu dhe kryetarin e nderit Rexhep Sadiku për të vizituar bashkërisht kuvendin komunal e për t'u takuar me kryetarin Agim Aliu dhe drejtorin e DKA-së Afrim Llabjani.



Kryetari Aliu ka shprehur respekt të lartë për angazhimet e kryetarit Jasharaj dhe stafit qendror të SBASHK-ut duke u shprehur se do të vazhdojë bashkëpunimin me sindikatën në nivel komunal në shërbim të arsimit dhe të realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë. Kryetari Jasharaj ka falënderuar mikpritësit duke shprehur respekt për angazhimet e tij dhe të shumë kryetarëve të tjerë të komunave në mbrojtje të kërkesave të SBASHK-ut. Koordinatorin për organizim të brendshëm Ymeri ka treguar për situatën aktuale dhe ka dhënë sqarime në shumë çështje të aktualitetit të sotëm.

Pas kësaj përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë shkuar në sallën e takimeve të kuvendit komunal dhe janë takuar me kryetarë të shoqatave të institucioneve arsimore të kësaj komune, të cilët në numër të madh i ishin përgjigjur ftesës për takim. Duke hapur kuvendin e punës, kryetari Vranovci ka përshëndetur pjesëmarrësit dhe ka falënderuar përfaqësuesit e SBASHK-ut për pjesëmarrje duke u shprehur i bindur se ata do të japin kontribut të çmuar në bashkëbisedë me pjesëmarrësit e këtij takimi.



Kryetari Jasharaj është shprehur se ka ardhur ti falënderojë koleget e kolegët e tij për unitetin e dëshmuar dhe për përkrahjen e vazhdueshme. Fjalimi i tij është përcjellë me duartrokitje nga pjesëmarrësit e këtij takimi.

Pas kësaj është zhvilluar një debat i frytshëm e konstruktiv dhe pjesëmarrësit kanë bërë pyetje të shumta në të cilat është përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymeri duke dhënë sqarime e duke ofruar argumente për secilën çështje për çka pjesëmarrësit e kanë falënderuar.